

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sika MonoTop®-160 Migrating

LLAÇ I HOLLË ME BAZË ÇIMENTOJE PËR HIDROIZOLIM BETONI ME ANË TË KRISTALIZIMIT



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sika MonoTop®-160 Migrating është llaç i hollë me 1 përbërës dhe me bazë çimentoje për hidroizolim i modifikuar me agregate të përzgjedhura dhe kimikate aktive. Përbërësit aktivë migrojnë brenda poreve të betonit dhe rrjetit kapilar dhe hyjnë në reaksion me lagështinë prezente dhe gëlqeren e lirë për të formuar një strukturë kristaline të patretshme brenda rrjetit. Llaçi mund të aplikohet me furçë ose spërkatje dhe krijon një shtresë të hidroizoluar për parandalimin e depërtimit të ujit në të gjitha llojet e strukturave prej betoni.

PËRDORIMET

- Hidroizolim i strukturave si basenet, muret mbajtës, puseta uji etj.
- Hidroizolim i elementeve prej betoni
- Hidroizolim pozitiv dhe negativ

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Migrim i përbërësve aktivë dhe formim kristalin për izolimin e rrjetëzimit kapilar
- Produkt me 1 përbërës, thjesht shtoni ujë
- Konsistencë llaçi të hollë për aplikim të shpejtë dhe të lehtë me furçë ose me metodën e spërkatjes me presion të ulët
- Për hidroizolim pozitiv dhe negativ
- Ndërkapje e shkëlqyer mbi beton
- I përshkueshëm nga avujt e ujit
- Aplikim mbi beton dhe llaçet për riparim

MIRATIME / STANDARDE

- Markë CE dhe Deklaratë Performance sipas EN 1504-2 - Sisteme për mbrojtjen e sipërfaqes së betonit - veshje.

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Bazë çimentoje, agregate të përzgjedhura dhe kimikate aktive
Ambalazhi	thes 25 kg
Paraqitja / Ngjyra	Pluhur gri
Jetëgjatësia	6 muaj nga data e prodhimit
Kushtet e magazinimit	Produkti duhet të ruhet në ambalazhin origjinal, të padëmtuar dhe të mbyllur, në kushte të thata dhe temperatura midis +5°C dhe +35°C. Lexoni gjithmonë ambalazhin.
Përmasa maksimale e kokrrizës	Dmax: ~ 0,3 mm
Deklarata e produktit	EN 1504-2 - Sisteme për mbrojtjen e sipërfaqes së betonit - veshje.

TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca e ndërkapjes në tërheqje ~ 2.0 N/mm² (EN 1542)

Reagimi ndaj zjarrit	Kategoria A1	(EN 13501-1)
Përshkueshmëria e avujve të ujit	Kategoria I (i përshkueshëm)	S _D < 5 m (EN ISO 7783-1)
Absorbueshmëria kapilare	~0,9 kg/m ² · h ^{0,5}	(EN 1062-3)
Depërtimi i ujit nën presion	~ 3 herë më pak depërtim krahasuar me mostrën për referencë (presion uji 5 bar për 72 orë)	(EN 12390-8)
Depërtimi i ujit nën presion negativ	~ 1,7 herë më pak depërtim krahasuar me mostrën për referencë (presion uji 5 bar)	(EN 12390-8, i modifikuar)

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzjerjes	~ 9,2 litra ujë për 25 kg pluhur
Dendësia e llaçit të freskët	~ 1,9 kg/l
Konsumimi	~1,2 kg/m ² për shtresë. Vlera është teorike dhe nuk përfshin asnjë material shtesë të kërkuar për shkak të porozitetit dhe profilit të sipërfaqes, ndryshimet në nivel, firon, etj.
Trashësia e shtresës	~ 1,0mm
Temperatura e mjedisit	+10 °C min / +35 °C max
Temperatura e nënshtresës	+10 °C min / +35 °C max
Koha e punueshmërisë	20–25 minuta në +20 °C
Koha e pritjes / mbiveshja	Aplikoni shtresën e 2-të ndërsa shtresa e 1-rë është akoma e freskët (shtresë e lagur mbi të lagur, 1-2 orë në 20 °C)

UDHËZIME APLIKIMI

PAJISJET

Përgatitja e nënshtresës

- Mekanikisht ose rrymë uji në presion shumë të lartë
- Përzjerja
- Mikser dore në shpejtësi të ulët (< 500 rpm)
- Enë për përzjerje

Aplikimi

- Manual – furçë për llaç të hollë
- Spërkatje e lëngshme – Makineri spërkatjeje me presion të ulët

Tharja

- Pajisje për spërkatje uji, membranë gjeotekstile për lagështinë, fletë polietileni

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

Të gjitha lidhjet midis nënshtresës dhe hyrjeve të tubave, impianteve dhe pajisjeve, çelësave të dritave, etj. duhet të mbyllen dhe të hidroizolohen përpara aplikimit të Sika MonoTop®-160 Migrating. Çdo fugë e pranishme tek struktura duhet gjithashtu të mbyllet dhe të hidroizolohet.

Nënshtresa e betonit duhet të jetë plotësisht e pastër, pa pluhur, materiale të shpërbëra, ndotës të sipërfaqes, kore çimentoje (qumësht) dhe materiale të cilat reduktojnë ndërkapjen ose parandalojnë përthithjen ose lagjen nga veshja me llaçin. Sipërfaqet duhet të përgatiten me një pajisje të pranueshme përgatitjeje derisa të arrihet një teksturë e hapur për të pasur vlerën e kërkuar të ndërkapjes për sistemin e hidroizolimit.

PËRZIERJA

Hidhni sasinë minimale të rekomanduar të ujit të pastër brenda një ene të përshtatshme për përzjerje. Ndërsa jeni duke përzierë ngadalë, shtoni vazhdimisht të gjithë thesin me pluhur tek uji. Pasi të jetë përfunduar një miks konsistent, vazhdoni përzjerjen për 3 minuta. Konsistenca duhet kontrolluar pas çdo përzjerjeje.

APLIKIMI

Përpara aplikimit, saturoni plotësisht me ujë të pastër nënshtresën e përgatitur për të arritur një sipërfaqe me tharje të saturuar (saturated surface dry, SSD). Përpara aplikimit largoni ujin e tepërt, p.sh. me një sfungjer të pastër.

Në përgjithësi

Sika MonoTop®-160 Migrating duhet të aplikohet mbi të gjithë sipërfaqen në trashësinë e kërkuar të shtresës.

Aplikim manual

Aplikoni materialin e përzierë mbi nënshtresën e përgatitur dhe paraprakisht të lagur me furçën e përshtatshme për llaçin duke e punuar llaçin mirë mbi nënshtresë dhe pa formuar hapësira. Duhet të aplikohet një shtresë e 2-të 'e lagur mbi të lagur' pasi të jetë ngurtësuar lehtësisht shtresa e 1-rë për të siguruar mbulimin e plotë të sipërfaqes dhe shmangien e krijimit të vrimave të vogla.

Aplikim me spërkatje - spërkatje e lëngët

Sika MonoTop®-160 Migrating i përzierë në formë të lëngët duhet të hidhet brenda pajisjes për spërkatje dhe të aplikohet mbi nënshtresën që është lagur paraprakisht. Duhet të aplikohet një shtresë e 2-të 'e

lagur mbi të lagur' pasi të jetë ngurtësuar lehtësisht shtresa e 1-rë për të siguruar mbulimin e plotë të sipërfaqes dhe shmangien e krijimit të vrimave të vogla.

METODA E MATURIMIT

Mbroni menjëherë llaçin e freskët nga tharja e parakoshme me anë të metodës së përshtatshme, p.sh. spërkatje me ujë, membranë gjeotekstili për lagështinë, fletë polietileni, etj. Duhet të maturohet për të paktën 5 ditë pas aplikimit.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit me ujë menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar mund të hiqet vetëm mekanikisht.

KUFIZIME

- Mos shtoni ujë mbi dozën e rekomanduar
- Mbroni materialin e freskët të aplikuar nga ngrica dhe shiu të paktën gjatë kohës së tharjes
- Shmangni aplikimin në diell të drejtpërdrejtë dhe/ose erë të fortë
- Mos aplikoni Sika MonoTop®-160 Migrating në temperatura nën +10 °C
- Shmangni grumbullimin e ujit ose kondensimin mbi sipërfaqet përpara aplikimit
- Sika MonoTop®-160 Migrating nuk është i përshtatshëm si një trajtim dekorativ
- Sika MonoTop®-160 Migrating nuk formon një veshje fleksibël dhe mund të plasaritet nën subjektin e lëvizjes

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sika MonoTop®-160 Migrating

Maj 2019, Botimi 01.01

020701010010000287

SikaMonoTop-160Migrating-sq-AL-(05-2019)-1-1.pdf